

AKTI I THEMELIMIT
&
STATUTI I SHOQËRISË
Star Investment Group sh.p.k
(Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar)

Në bazë të Ligjit 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 131/2015, datë 26.11.2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit, i ndryshuar, u vendos si më poshtë vijon:

KREU 1
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1

Data e themelimit dhe emri i shoqërisë

Sot më datë 11.10.2023 ne themeluesit kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **Star Investment Group sh.p.k** (në vijim referuar si “**Shoqëria**”).

Themeluesit e Shoqërisë janë :


1: ADRIATIK HYSENBELLIU, i biri i Qemal,i datëlindjes 16-08-1959,lindur në Radesh, Skrapar dhe banues në Yzberish, Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 14 , Tirane madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me dokument identifikues kartë me nr.personal F90816118L , madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

2: Z.ALKET MESLANI , i biri i Neim -it , i datëlindjes 06-09-1974, lindur në Poliçan, Skrapar , banues në Bashkia Tiranë - Njësia Bashkiake Nr. 5 , Tirane , madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me dokumentin kartë me nr.personal H40906080N , madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

3: Z.GERTI ÇALLIKU, i biri i Petrit-it, i datëlindjes 03-09-1976, lindur në Tiranë, banues në Bashkia Tiranë - Njësia Bashkiake Nr. 7, Tirane, Stavri Themeli 5/9, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar me dokument identifikues kartë me nr.personal H60903146W , madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

4: Z.BERNARD NDOJ, i biri i Nikoll-it, i datëlindjes 25-06-1976, lindur në Kimez, banues në Bashkia Tiranë - Njësia Bashkiake Nr. 9 , Tirane, Rruga Sheh Rexhep Kubati , madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar me dokument identifikues kartë me nr.personal H60625119L , madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

5 : Z.DRITAN ABAZI, i biri i Fuat-it, i datëlindjes 03-10-1976, lindur në Fushe Kruje, banues në Bashkia Tiranë - Njësia Bashkiake Nr. 11, Rruga Mustafa Kacaci, Vila Nr 8 , madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar me dokument identifikues kartë me nr.personal H61003106J , madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

15.10.2023




Neni 2

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

Aktivite të ndryshme në fushën e ndërtimit dhe në pasuri të paluajtshme. Investimin në projekte në fushën e ndërtimit, turistike apo rezidenciale apo në zhvillimin e pasurive të paluajtshme në përgjithësi. Gjithashtu shoqëria mund të kryejë cdo aktivitet tjetër të nevojshëm për realizimin e qëllimeve të saj përfshirë edhe aktivitetin e ofrimit të shërbimeve të konsulences, tregtimin e mallrave të ndryshëm, etj. Për të arritur objektin e saj, Shoqëria mund të marrë pjesë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të terthortë në shoqëri të tjera shqiptare e të huaja, si edhe të hyjë në marrëdhënie kontraktore, bashkëpunimi ose ortakërie me persona të tretë, private ose publike, vendas ose të huaj. Shoqëria mund të ushtrojë çfaredolloj aktiviteti tjetër të çfaredolloj natyre që nuk është në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi pa asnjë kufizim.

Neni 3

Kohëzgjatja

1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është për një afat të pacaktuar.

Neni 4

Selia

1. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën- Rruga Teodor Keko, Rezidenca Future Home, me numer pronësie 306/423+4-30.
2. Shoqëria ka të drejtë të hap degë apo filiale, zyra përfaqësimi, në të gjithë vendin, brenda ose jashtë territorit të vendit, gjatë aktivitetit të saj.

Neni 5

Të Ndryshme

1. Kjo Shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, selinë, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të znadhojë kapitalin sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë dhe sipas parashikimeve të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali i regjistruar

1. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 100,000 (njqind mijë) Lekë, i përbërë nga 5 kuota. Kapitali i regjistruar është plotësisht i paguar, dhe përbëhet nga kuotat, e zotëruara nga Ortakët në përputhje me nenin 7 dhe shtojcës 1 të këtij Statuti.

Neni 7

Ortakët e Shoqërisë

1. Ortakët e Shoqërisë janë Personat që kanë përfituar kuotën e tyre në Shoqëri në përputhje me kontributin e tyre. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë ndahet midis Ortakëve në kuota në përputhje me kontributet



përkatëse në kapital. Kontributi mund të jetë në para ose natyrë (pasuri të luajtshme apo të paluajtshme apo të drejta të ortakëve)

2. Ortakët aktuale të Shoqërise janë të listuar në Shtojcën 1 që i bashkëlidhet këtij Statuti.

Neni 8


Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

1. Zmadhimi i kapitalit të Shoqërise kryhet me vendim të Asamblese së Ortakëve.
2. Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me anë të përfshirjes së fitimeve apo rezervave në kapital ose me ane të kontributeve të reja.
3. Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar me anë të kontributëve të reja në para, këto kontribute duhet të nënshkruhen jo më vonë se 30 ditë pasi është vendosur rritja e kapitalit. Këto kontribute duhet të shlyhen plotësisht jo më vonë 30 ditë pas datës së nënshkrimit. Asambleja e Ortakëve mund të përcaktojë afate të ndryshme në vendimin e zmadhimit të kapitalit.
4. Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar me anë të kontributeve të reja në natyrë, këto kontribute duhet t'i transferohen Shoqërise përpara regjistrimit në Regjistrin Tregtar. Vlerësimi i kontributeve të reja në natyrë do të kryhet në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar.
5. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të Shoqërisë.
6. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
7. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 9

Fitimi dhe kalimi i kuotave

1. Kuotat e kapitalit të Shoqërisë si dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen nëpërmjet :
 - a. kontributit në kapitalin e Shoqërisë;
 - b. shitblerjes së kuotave;
 - c. trashëgimisë;
 - ç. dhurimit;
 - d. çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.
2. Kuotat e kapitalit të Shoqërise janë të transferueshme lirisht ndërmjet ortakëve.
3. Personi që kalon kuotën dhe ai që fiton atë përgjigjet në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës nga çasti i kalimit të kuotave deri në çastin e regjistrimit të kalimit.
4. Në rast të transferimit të kuotave tek persona të tjerë jashtë Shoqërise, qofte me shitje apo qofte me dhurim, ortaku që synon të transferojë kuotat duhet të komunikojë ortakëve të tjerë vullnetin e tij me shkrim. Ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes të kuotave të ortakëve, me kushte të barabarta, dhe

10023






duhet ta ushtrojne kete te drejte brenda 60 diteve nga marrja e komunikimit te vullnetit te ortakut per te transferuar kuotat . Mosrespektimi i kesaj dispozite e ben te pavlefshem transferimin e kuotave .

5. Perjashtimisht nga sa me siper, e drejta e parablerjes nuk zbatohet ne rastet kur bleresi i mundshem i trete eshte bashkeshorti/bashkeshortja/ apo femijet. Ne kete rast kuotat e kapitalit jane te transferueshme lirisht midis paleve.
6. Vlera e kuotes qe transferohet do te percaktohet nga nje ekspert i emeruar nga ortaket me marreveshje ose nga gjykata ne rast se ortaket nuk bien dakort .

KREU III


ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 10

Organi vendimarrës

1. Organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.
2. Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteve të përcaktuara në ligj.
3. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të përshkruara si më poshtë:
 - a. përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - b. ndryshimet e statutit;
 - c. emërimin e shkarkimin e administratorit;
 - ç. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
4. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi (me prokure me shkrim), nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
5. Administratori i Shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
6. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 11

The bottom of the page contains several handwritten signatures and initials in blue ink. On the left, there is a large, stylized signature. In the center, there is a signature that appears to be 'Beccey' with the number '10023' written above it. To the right of this is another large, stylized signature. Further right, there is a signature that looks like 'Jury' with a large flourish. On the far right, there are some initials that look like 'V' and 'L'.

Mënyra e thirrjes së Asamblesë së përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur Asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas paragrafit të mësipërm të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 12

Kuorumi

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
2. Në rastin kur Asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të kuotave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
3. Nëse Asambleja e përgjithshme nuk mund të mbliidhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur në paragrafin e mësipërm të këtij neni, asambleja mbliidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 13

Marrja e vendimeve

1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :
 - a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b. emërimin dhe shkarkimin e administratoreve;
 - c. emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d. përcaktimin e shpërblimeve të personave të përcaktuar në pikat b dhe c të këtij paragrafi;
 - dh. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - e. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - g. pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

10023 



17

- h. miratimin e pasqyrave financiare vjetore te shoqerise dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
3. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për të pasqyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.

Neni 14

Përfashtim nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga Shoqëria;
 - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 15

Administrimi

1. Shoqëria administrohet nga një administrator i cili caktohet në statutin e Shoqërisë dhe më pas nga Vendimet Asamblesë së Ortakëve. Administratori qëndron në detyrë për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh me të drejtë riemërimi nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.
2. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:
- a. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b. përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç. përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - d. krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh.
 - e. raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - ë. kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
 - f. të therrase Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
 - i. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3

muajve në vazhdim;

- ii. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- iii. shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

4. Administrator i Shoqërisë është **Z.GERTI ÇALLIKU**, i biri i Petrit-it, i datëlindjes 03-09-1976, lindur në Tiranë, banues në Bashkia Tiranë - Njësia Bashkiake Nr. 7 |Tirane, Stavri Themeli 5/9, madhor, me zotesi të plotë juridike dhe për të vepruar me dokument identifikues kartë me nr.personal H60903146W , madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Specimeni i nënshkrimit të Administratorit është sipas përcaktimit në shtojcën 2 bashkëlidhur statutit.

Neni 16

Përgjegjësitë e Administratorit

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj Shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.
2. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm Shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatëse.
3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare“, i ndryshuar, Administratori detyrohet:
 - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të Shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
4. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj Shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale,

10023

të parashikuara, është i detyruar t'i dëmshpërblejë Shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

5. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë Shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit, "Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
 - a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - d) jep kredi.
6. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 17

Marrëdhëniet e punës

1. Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj Shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj Shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

Neni 18

Konfidencialiteti dhe

Ruajtja e sekretit

1. Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretët e të gjitha akteve dhe dokumentave që janë përcaktuar si të tilla nga Administratori i Shoqërisë.

KREU IV

VITI FINANCIAR-EKSPERTËT

Neni 19

Viti financiar



1. Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet në 31 Dhjetor.

Neni 20

Ekspertët

1. Kontrolli mbi veprimtarinë e Shoqërisë si dhe gjithë aktivitetin e Shoqërisë i besohet një eksperti. Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të Shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.
2. Në rast se kerkohet nga ligji, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabel të Shoqërisë do të kryhet nga eksperti kontabel i emëruar për një periudhë 1 vjeçare me mundësi për tu rizgjedhur për një periudhë tjetër nga Asambleja e Përgjithshme.
3. Në përfundim të kontrollit eksperti i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka

KREU V


PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 21

Prishja dhe likuidimi

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:
 - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
 - d) me vendim të gjykatës;
 - dh) për arsye të tjera, të parashikuara në statut.
2. Në rast se Shoqëria shpërndahet për çdo lloj arsye Asambleja e Ortakëve përcakton mënyrën e likuidimit, emëron një ose më tepër likuidator dhe përgatit të gjitha dokumentet e nevojshme për rregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit. Në rast se ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues.

Neni 22



The bottom of the page features several handwritten signatures and initials in blue ink. On the left, there is a signature that appears to be 'A0023' followed by a large, stylized signature. To the right of this, there is a smaller signature. Further right, there are two more distinct signatures, one of which is quite large and complex. On the far right, there are some initials that look like 'JJ'.

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi- ndarja

1. Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

Neni 23

Baza ligjore

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e të saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisilacionit shqiptar në fuqi.

Neni 24

Mosmarrëveshjet

1. Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 25

Dispozitat Përfundimtare

1. Ky statut do të hyjë në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij nga themeli i shoqërisë.
2. Të gjitha ndryshimet e këtij statuti do të aprovohen përmes së njejtës procedure.
3. Në të gjitha çështjet që nuk përcaktohen në këtë Statut do të aplikohen dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare

THEMELUESIT

Adriatik Hysenbelliu Buni Genë Seliku 2003
Alket Meslari Armen Daj
[Signature] [Signature]
Dritun Buni

SHTOJCA 1
(ORTAKËT E SHOQËRISË)

1: ADRIATIK HYSENBELLIU, i biri i Qemal, i datëlindjes 16-08-1959, lindur në Radesh, Skrapar dhe banues në Yzberish, Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 14 Tirane madhor, me zotesi të plotë juridike dhe për të vepruar, me dokument identifikues kartë me nr.personal F90816118L , madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, është zoterues i 1 kuote ose , me vlerë të përgjithshme 25 000 leke , që përbejnë 25 % të kapitalit themeltar .

2: ALKET MESLANI , i biri i Neim -it , i datëlindjes 06-09-1974, lindur në Poliçan, Skrapar , banues në Bashkia Tiranë - Njësia Bashkiake Nr. 5 Tirane , madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me dokumentin kartë me nr.personal H40906080N , madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar është zoterues i 1 kuote ose , me vlerë të përgjithshme 25 000 leke , që përbejnë 25 % të kapitalit themeltar .

3: Z.GERTI ÇALLIKU, i biri i Petrit-it, i datëlindjes 03-09-1976, lindur në Tiranë, banues në Bashkia Tiranë - Njësia Bashkiake Nr. 7 Tirane, Stavri Themeli 5/9, madhor, me zotesi të plotë juridike dhe për të vepruar me dokument identifikues kartë me nr.personal H60903146W , madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar është zoterues i 1 kuote ose , me vlerë të përgjithshme 30000 leke , që përbejnë 30 % të kapitalit themeltar .

4: Z.BERNARD NDOJ, i biri i Nikoll-it, i datëlindjes 25-06-1976, lindur në Kimez, banues në Bashkia Tiranë - Njësia Bashkiake Nr. 9 Tirane, Rruga Sheh Rexhep Kubati , madhor, me zotesi të plotë juridike dhe për të vepruar me dokument identifikues kartë me nr.personal H60625119L , madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar; është zoterues i 1 kuote ose , me vlerë të përgjithshme 10 000 leke , që përbejnë 10% të kapitalit themeltar .

5: Z.DRITAN ABAZI, i biri i Fuat-it, i datëlindjes 03-10-1976, lindur në Fushe Krujë, banues në Bashkia Tiranë - Njësia Bashkiake Nr. 11, Mustafa Kacaci, Vila Nr 8 , madhor, me zotesi të plotë juridike dhe për të vepruar me dokument identifikues kartë me nr.personal H61003106J , madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar; është zoterues i 1 kuote ose , me vlerë të përgjithshme 10000 leke , që përbejnë 10 % të kapitalit themeltar .

Adriatik Hysenbelliu GERTI ÇALLIKU 10023
Alket Meslani Bernard Ndoj
Dr. Dritan Abazi

SHTOJCA 2

(Specimeni i Nënshkrimit të Administratorit)

LEON Jelliker
2023